

VENDIM
Nr.592, datë 18.8.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.383, DATË 19.6.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, TARIFAVE DHE MASËN E MBULIMIT TË SHËRBIMEVE EKZAMINUESE UNIKALE, TERCIARE, TË PËRFSHIRA NË SIGURIMIN SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, shkronja “c”, e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 5 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.383, datë 19.6.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 të shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
“1/1. Në listën e ekzaminimeve unike, terciare dhe të tarifave, të përcaktuar në pikën 1, të vendimit, shtohen dhe ekzaminimet, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
2. Në pikën 5, pas fjalëve “...listën e përmendur në pikën 1...”, të shtohen fjalët “...dhe pikën 1/1...”.
3. Pika 8 të ndryshohet, si më poshtë vijon:
“8. Të ardhurat e përfituara të kalojnë në buxhetin e institucionit shëndetësor terciar si të ardhura jashtë limitit, dhe përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me vendimin nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.
4. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha